



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK
TË TIRANËS**

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

(Auditim Tematik)

“UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS” (UPT)

Prill 2024



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI (*Auditim Tematik mbi bazë verifikimi*)

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
		3-8
1	Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.	3-8
3	Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.	8
II	HYRJA	9-12
1	Titulli	9
2	Marrësi	9
3	Objektivat dhe qëllimi	9
4	Identifikimi i çështjes	9
5	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9-10
6	Përgjegjësitë e audituesve	10
7	Kriteret e vlerësimit	10
8	Standardet e auditimit	11
9	Metodat e auditimit	11
10	Dokumentimi i auditimit	11-12
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12-20
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit:	13-14
2.1	Verifikimi i çështjeve të trajtuara në ankesën nr. 600 prot., datë 15.11.2023.	15-20
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	21-23



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Universiteti Politeknik i Tiranës, më poshtë e emërtuar “UPT”, në zbatim të autorizimit nr. 1015/1 prot., datë 15.11.2023, me objekt “Mbi kryerjen e verifikimit të çështjeve të trajtuara në ankesën nr. 600 prot., datë 15.11.2023”.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në një konkluzion të përgjithshëm në lidhje me auditimin tematik. Gjatë zhvillimit të këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja e funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Grupi i auditimit ka hartuar këtë Raport Përfundimtar auditimi, duke reflektuar edhe sqarimet e subjektit nga Administratori i Universitetit Politeknik i Tiranës z.B.A. me shkresën nr.363/1 datë 12.03.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1015/5, dt 13.3.2024, sa i takon Projektraportit të auditimit. Rezultatet dhe çështjet kryesore të këtij auditimi janë trajtuar në vijim të raportit përfundimtar, së bashku me konkluzionin e përgjithshëm dhe opinionin e auditimit.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	<p>1.1 Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës u konstatua se pasuria nr. 5/561, objekt i ankesës, nuk është regjistruar në kartelat e pasurive pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si pronë në përgjegjësi administrimi të Universitetit Politeknik të Tiranës, por ky i fundit ka të regjistruara në kontabilitet në zërin e aktiveve afatgjata materiale godinat –pjesë e kësaj pasurie, (në inventarin kontabël të llogarisë 212, “Ndërtesa dhe konstruksione”, regjistruar kjo godinë që nga viti 1991 me emërtimin “Ofiçina e Transportit”), bazuar në VKM-në nr. 215, datë 15.7.1991, “Për riorganizimin e Universitetit të Tiranës” dhe VKM-në nr. 359, datë 21.9.1991 “Për riorganizimin e disa fakulteteve të Universiteteve”.</p> <p>(Hollësisht trajtuar në pikën nr.II, faqe 6-10 të Raportit të Auditimit)</p>	<p>(Hollësisht trajtuar në pikën nr.II, faqe 11-20 të Raportit të Auditimit)</p>	E lartë	<p>Universiteti Politeknik i Tiranës të ngrëjë një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokave, trojeve dhe terreneve që i përkasin institucionit dhe pas përlllogaritjes së vlerave nga ekspertët e fushës, të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit të saj në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

	<p>1.2. Nga auditimi i shtruar në Universitetin Politeknik të Tiranës, në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” nuk kanë të regjistruar asnjë pronë/truall si aktive afatgjata materiale dhe rezultojnë me vlerën zero. Sa më sipër, vepruar në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, paragrafi 20 dhe 21, dhe paragrafit nr.21, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit SKK 1 “Kuatru i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”, si dhe VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, etj.</p> <p><i>(Hollësisht trajtuar në pikën nr.II, faqe 6-10 të Raportit të Auditimit)</i></p>			në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
2	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, lidhur me referencën 00013917 dhe referencën 0008261 si dhe shkresën me objekt “Kthim përgjigje” të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug me nr. 79/1 prot., datë 12.01.2024, (protokolluar në KLSH me nr. 1015/3 prot., datë 17.01.2024) rezultojnë se, pasuria 5/561, objekt i ankesës, në Kadastër është regjistruar vetëm si truall, në emërtesën</p>	<p><i>(Hollësisht trajtuar në pikën nr.II, faqe 11-20 të Raportit të Auditimit)</i></p>	E Lartë	2.1 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, si autoritet përgjegjës, Universiteti Politeknik i Tiranës si dhe Kryegjyshata Botërore e Bektashinjve, si subjekte/ persona me interes të ligjshëm ¹ , sipas

¹ - Neni 4 pika 2: Persona me interes të ligjshëm janë personat e tretë, të drejtat e të cilëve kanë të bëjnë me pasurinë për të cilën kërkohen të dhëna (sipas dokumentacionit provues) apo që ushtrojnë funksione publike, për realizimin e të cilave janë të nevojshme këto të dhëna.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

<p>"Shtet", duke mos pasqyruar në kartelën e pasurisë objektin me sipërfaqen përkatëse për të cilin ka të drejtën e parablerjes Kryegjyshata Botërore e Bektashinjve, bazuar në Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave me nr. 948, datë 12.12.1994, (regjistruar në Seksionin C të Kartelës). Gjithashtu referuar dokumentacionit të sipërcituar rezulton se në seksionin përkatës të kartelës për kufizimet mbi pasurinë nuk vërtetohet me dokumentacion ekzistenca e ndërtimeve të paligjshme (të regjistruara në kartelë), fakt ky i konfirmuar nga verifikimet e grupit të auditimit dhe nga informacioni i dërguar nga ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Jug.</p> <p>Me shkresën nr.2767/1 prot., datë 06.12.2023 të Universitetit Politeknik të Tiranës me lëndë "Informacion në kuadër të verifikimit", theksohet se objektet në këtë pronë kanë shërbyer për riparimin dhe qëndrimin e automjeteve të institucionit, etj., ndërsa aktualisht përdoren për administrimin e automjeteve, magazinimin e bazës materiale, të fakulteteve të UPT</p>			<p>nenit 4 pika 2 dhe bazuar në nenin 16 e 37, të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën", të ndërmarrin veprimet e nevojshme me qëllim korrigjimin e gabimeve materiale të krijuara gjatë procesit të regjistrimit fillestar, për të bërë të mundur pasqyrimin në seksionin përkatës të Kartelës së Pasurisë nr. 5/561, volumni 22, fq.87, ZK 8180, objektin real si dhe fshirjen e kufizimit të vendosur pa mbështetje ligjore.</p> <p>2.2 Strukturat përkatëse pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në ushtrim të të drejtës së përfaqësuesit të pronës shtetërore, referuar nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.04.1995 i ndryshuar, si dhe në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" me ndryshimet dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, të marrin masat për</p>
---	--	--	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

				<p>shqyrtimin dhe analizimin e statusit aktual të pronës në lidhje me zhvillimin e saj, duke koordinuar veprimet me Universitetin Politeknik të Tiranës për sa më sipër.</p> <p>2.3 Institucionet shtetërore përgjegjëse të ndërmarrin procedurat për zhvillimin e pronës, bazuar në Nenin 22, pika 2, të Ligjit Nr.10058, datë 22.1.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshitës Botërore Bektashiane për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, ku përcaktohet se “Shteti do t’i kthejë dhe kompensojë Kryegjyshitës Botërore Bektashiane të gjitha pronat, me përparësi objektet e kultit tashmë të njohura nga të gjithë, të cilat kanë qenë për shekuj qendra shpirtërore dhe kulturore të komunitetit bektashian dhe përbëjnë historinë e këtij komuniteti, si objektet e kultit,</p>
--	--	--	--	--



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

			<p><i>vendet e shenjta, sendet e kultit dhe arkivat e saj të konfiskuara nga regjimi komunist” dhe Nenin 14, “E drejta e parablerjes”, pika 1, e Ligjit Nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, që shpreh se “Për pronat e paluajtshme të zëna me objekte shtetërore, subjektet e shpronësuara kanë të drejtën e parablerjes mbi këto objekte kur ato të privatizohen. E drejta e parablerjes regjistrohet në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. Në kushtet që Universiteti Politeknik i Tiranës nuk zotëron asnjë titull pronësie për pasurinë nr. 5/561, si dhe vlera e truallit nuk është regjistruar në kontabilitetin e tij, për të cilën Kryegjyshata Botërore Bektashiane edhe sipas regjistrave të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ka të drejta reale pronësore, referuar Vendimit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nr. 948,</i></p>
--	--	--	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

				datë 12.12.1994, pika 2/b, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të vlerësojë inicimin e procedurave të nevojshme ligjore me qëllim vënien në dobi të komunitetit bektashian të kësaj prone dhe, aty ku sipas ligjit kjo është e pamundur, kompensimin e saj.
--	--	--	--	---

I.3. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT.

Në përfundim të auditimit tematik të ushtruar në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe të procedurave të ndjekura, lidhur me verifikimit të çështjeve të trajtuara në ankesën e paraqitur nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane me nr. 600 prot., datë 15.11.2023”, protokolluar në KLSH me nr. 1015, datë 15.11.2023, Audituesit e KLSH-së kanë arritur në konkluzionin, si më poshtë:

Kanë rezultuar disa pasaktësi dhe mangësi në regjistrimin e elementeve të aktiveve afatgjata materiale në kontabilitetin e Universitetit Politeknik të Tiranës dhe nuk janë finalizuar procedurat e regjistrimit të pasurisë shtetërore në mënyrë të plotë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:
Strukturat drejtuese të Universitetit Politeknik të Tiranës janë përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së: Përgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Universitetit Politeknik të Tiranës, në lidhje me çështjet e trajtuara në ankesën e administruar.

Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të autorizimit nr. 1015/1 prot., datë 15.11.2023, “*Mbi kryerjen e verifikimit të çështjeve të trajtuara në ankesën nr. 600 prot., datë 15.11.2023*”, nga data 22.11.2023 deri në datën 15.12.2023, u krye verifikimi i dokumentacionit që posedon Universiteti Politeknik i Tiranës në lidhje me pasurinë e paluajtshme me nr. 5/561, në zonën kadastrale 8180, TR; 0-16. Verifikimi i iniciuar nga ankesa e ardhur në KLSH me nr. 600 prot., datë 15.11.2023, protokolluar me tonën me nr.1015 prot., datë 15.11.2023, ankesë e ardhur nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane, u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E.SH., përgjegjës grupi;
2. B.B., anëtare;
3. A.Xh., anëtare.

a) Titulli:

Raporti përfundimtar i Auditimit Tematik mbi verifikimin e dokumentacionit që posedon Universiteti Politeknik i Tiranës në lidhje me pasurinë e paluajtshme me nr. 5/561, në zonën kadastrale 8180, TR; 0-16, trajtuara dhe në ankesën nr. 600 prot., datë 15.11.2023.

b) Marrësi:

Ky Raport përfundimtar i adresohet Universitetit Politeknik të Tiranës, Administratorit z. B. A. për verifikimin e dokumentacionit që posedon Universiteti Politeknik i Tiranës në lidhje me pasurinë e paluajtshme me nr. 5/561, në zonën kadastrale 8180, TR; 0-16.

METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

a) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objekti i këtij auditimi është verifikimi i dokumentacionit që posedon Universiteti Politeknik i Tiranës në lidhje me pasurinë e paluajtshme me nr. 5/561, në zonën kadastrale 8180, TR; 0-16.

Qëllimi i auditimit është vlerësimi i saktësisë së regjistrimit të pasurisë (zëri ndërtesa dhe toka troje e terrene,, objek i ankesës së administruar në KLSH, nga ana e Universitetit Politeknik të Tiranës. Përkatësisht: objekt i analizës dhe testeve të vlerësimit nga ana e audituesve të autorizuar të KLSH, i pasurisë së paluajtshme me nr. 5/561, në zonën kadastrale 8180, TR; 0-16.

b) Identifikimi i çështjes:

Fushëveprimi i këtij auditimi është verifikimi i dokumentacionit që posedon Universiteti Politeknik i Tiranës në lidhje me pasurinë e paluajtshme me nr. 5/561, në zonën kadastrale 8180, TR; 0-16, sipas autorizimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr. 1015/1, datë 22.11.2023, mbi “Mbi kryerjen e verifikimit të çështjeve të trajtuara në ankesën nr. 600 prot., datë 15.11.2023”.

c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Universiteti Politeknik i Tiranës është institucion publik i arsimit të lartë, i llojit universitet, në përputhje me përcaktimet e kornizës ligjore në fuqi, i pavarur nga çdo orientim fetar, ideologjik dhe politik. Universiteti Politeknik i Tiranës ka statusin e personit juridik publik.

UPT e ushtron veprimtarinë në pronat e paluajtshme, të cilat i kanë kaluar në administrim me vendim të Këshillit të Ministrave. UPT ka detyrimin e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së pronave në administrim si dhe ka të drejtë të krijojë pasuri të paluajtshme dhe t'i administrojë ato në funksion të interesit të tij.

Strukturat drejtuese të Universitetit Politeknik kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar, kontabilitetit dhe kontrollit të brendshëm, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Ato janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësisë të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator.

Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

d) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objekti ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputshmërinë e detyrimeve kontraktuale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare e natyrore të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

e) Kriteret e vlerësimit:

- Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar;
- Ligji nr. 111/2018, “Për kadastrën”;
- VKM-në nr. 215, datë 15.7.1991, “Për riorganizimin e Universitetit të Tiranës”;
- VKM-në nr. 359, datë 21.9.1991, “Për riorganizimin e disa fakulteteve të Universiteteve”;
- VKM-në nr. 500, date 14.8.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar;
- VKM-në nr. 669, datë 07.08.2013, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH), si metadatë”, i ndryshuar;
- VKM-në nr. 782, datë 07.10.2020, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

- Vendimi nr.107, datë 08.08.2017 “Për miratimin e procedurave të auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit”, i ndryshuar;
- Dokumentacioni i cituar në shkresën nr. 2767/1 prot., datë 06.12.2023.

f) Standardet e Auditimit

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik (ISSAI).

- ISSAI 100 - (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.
- ISSAI 4000 “Standarti i Auditimit të Përputhshmërisë”
- INTOSAI-P 10“Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e - SAI-t”, si dhe INTOSAI-P 30“ Kodi Etikës”.
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 197, datë 12.10.2022, Rregullore “Mbi Procedurat e auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së, e ndryshuar.

g) Metodatat e auditimit

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar gjatë fazës së planifikimit dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga subjekti i audituar. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontroleve të brendshme në institucion sa i takon:

(a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontroleve.

1. *Kontroll aritmetik* që konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin.

1. *Inspektim fizik* dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse.

2. *Kontrolli i vlerësimit* për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, në përputhje me vlerat e paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3-*Verifikimi i transaksioneve* duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese.

4-*Intervistimi i personelit* që ka patur role specifike në subjektin që u auditua.

5-*Raporte dhe informacione* nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore.

6-*Pyetësorë* për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

h) Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të fazës së auditimit në terren si dhe referuar të dhënave të grumbulluara në institucionin Universiteti Politeknik i Tiranës në lidhje me ankesën e paraqitur nga z. H.B.E.B, Kryegjysh Botëror i Bektashinjve me nr. 600 prot., datë 15.11.2023, administruar në KLSH me praktikën nr. 1015 prot., datë 15.11.2023, është mbajtur akt-verifikimi nr. 1, datë 15.12.2023, i protokolluar në UPT me nr.2667/2 prot., datë 15.12.2023, mbi bazën e të cilit u përgatit Projekt-Raporti i Auditimit Tematik .

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Auditimi i ushtruar në Universitetin Politeknik të Tiranës, në bazë të programit të auditimit nr. 1015/1 prot., datë 15.11.2023, “Mbi kryerjen e verifikimit të çështjeve të trajtuara në ankesën nr. 600 prot., datë 15.11.2023”. UPT e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin nr. 80, datë 21.05.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me legjislacionin dhe rregullat në fuqi, evidencat e marra të auditimit që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

- Objekt i këtij auditimi është auditimi i procedura të ndjekura nga ana e Universitetit Politeknik të Tiranës për pronat në posedim të tij.
- Qëllimi i auditimit: Auditimi tematik mbi vlerësimin e procedurave të ndjekura nga ana e UPT
- Fushëveprimi i auditimit: Zbatimi i dispozitave ligjore për pronat e paluajtshme të shtetit mbi bazën e të cilit posedohen pronat nga entet publike, sipas autorizimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së në bazë të programit të auditimit nr. 1015/1 prot., datë 15.11.2023, mbi “Mbi kryerjen e verifikimit të çështjeve të trajtuara në ankesën nr. 600 prot., datë 15.11.2023”.

3. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

Në zbatim të programit të auditimit në bazë të programit të auditimit nr. 1015/1 prot., datë 15.11.2023, mbi “Mbi kryerjen e verifikimit të çështjeve të trajtuara në ankesën nr. 600 prot., datë 15.11.2023”, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

Verifikimi iu referua akteve ligjore e nënligjore si në vijim:

- Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;




KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

- Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar;
- Ligji nr. 111/2018, “Për kadastrën”;
- VKM-në nr. 215, datë 15.7.1991, “Për riorganizimin e Universitetit të Tiranës”;
- VKM-në nr. 359, datë 21.9.1991, “Për riorganizimin e disa fakulteteve të Universiteteve”;
- VKM-në nr. 500, date 14.8.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar;
- VKM-në nr. 669, datë 07.08.2013, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH), si metadatë”, i ndryshuar;
- VKM-në nr. 782, datë 07.10.2020, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.
- Vendimi nr.107, datë 08.08.2017 “Për miratimin e procedurave të auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit”, i ndryshuar;
- Dokumentacioni i cituar në shkresën nr. 2767/1 prot., datë 06.12.2023.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupi i auditimit konstatoi se pasuria e paluajtshme me nr. 5/561, në zonën kadastrale 8180, TR; 0-16 objekt i ankesës është bërë pjesë e aktiveve të Universitetit Politeknik të Tiranës, në kuadër të procesit të riorganizimit të Universitetit të Tiranës dhe ndarjes së aktivitetit të tij në dy universitete, në përputhje me VKM-në nr. 215, datë 15.7.1991, “Për riorganizimin e Universitetit të Tiranës” dhe VKM-në nr. 359, datë 21.9.1991 “Për riorganizimin e disa fakulteteve të Universiteteve”. Bashkëlidhur VKM nr. 215, datë 15.07.1991 të sipërcituar është mbajtur dhe akt-marrëveshja, datë 02.09.1991 midis Universitetit të Tiranës dhe Universitetit Politeknik të Tiranës ku bien dakord mbi ndarjen e aseteve. Referuar sa më sipër, pasuria e cila emërtohet Oficina e Transportit është pjesë e aktiveve afatgjata materiale të Universitetit Politeknik dhe është në shërbim të nevojave të Universitetit Politeknik.



Burimi: Pjesë e hartës digjitale, nga ASIG, Grupi i auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Në këtë pronë ndodhen dy objekte njëkatëshe, referuar dhe ortofotos marrë nga sistemi Asig gjeoportal. Me shkresën nr.2767/1 prot., datë 06.12.2023 të Universitetit Politeknik të Tiranës me lëndë “Informacion në kuadër të verifikimit”, theksohet se objektet në këtë pronë kanë shërbyer për

riparimin dhe qëndrimin e automjeteve të institucionit, si dhe për praktikat mësimore, ndërsa aktualisht përdoren për administrimin e automjeteve, magazinimin e bazës materiale, makinerive teknologjike dhe inventarit ekonomik të fakulteteve të UPT-së.

Grupi i auditimit me datë 12.12.2023, kreu verifikimin në terren mbi ekzistencën e dy godinave tip kapanone, në prani të përfaqësuesve të KLSH znj. E.Sh. dhe znj. B.B.dhe përfaqësuesve të UPT znj. E.H. arkitekte, z. M.Sh. inxhinier dhe z. A. Sh. punëtor mirëmbajtje.

Nga verifikimi në pasqyrat financiare të UPT-së viti ushtrimor 2022, rezulton se në listën e aktiveve afatgjata materiale, në inventarin kontabël llogaria 212, “Ndërtesa dhe konstruksione”, është e regjistruar kjo godinë që nga viti 1991 me emërtimin “Ofiçina e Transportit” me vlerë fillestare 67,055 lekë dhe vlera e tepcicës neto 34,349 lekë. Ndërsa në llogarinë 210 Toka, Troje, Terrene nuk kanë të regjistruar asnjë pronë/truall si aktive afatgjata materiale.

Sipas korrespondencave të mbajtura nga UPT në lidhje me këtë pronë, Drejtoria Ekonomike në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës i është drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Decentralizimit (përgjegjëse në atë kohë për asetet/pronat e Institucioneve Publike), me shkresën nr. 8020 prot., datë 4.11.2004 duke listuar në inventarin fizik të objekteve të arsimit të lartë në përdorim nga UPT, ku pasuria në fjalë listohet me emërtimin “Parku i Transportit” me sipërfaqe totale prone 1330 m² nga të cilat sipërfaqe ndërtese 680 m² me institucion përdorues Rektorati i Universitetit Politeknik.

Nga aktet shkresore të administruara, konkretisht rezulton se nga viti 2014 deri 2023 UPT ka kryer aplikime/korrespondenca të nevojshme me institucionet kompetente për kalimin në përgjegjësi administrimi të pronave të paluajtshme në posedim prej tij, përfshirë edhe pronën e paluajtshme shtetërore me nr. pasurie 5/561, në zonën kadastrale 8180, indeksi i hartës TR-O-16.

Referuar Planit Strategjik 2019 - 2024 të Universitetit Politeknik të Tiranës, Vendimit nr. 4, datë 15.03.2023 “Për miratimin e raportit financiar të buxhetit 2022 dhe raportin e detajuar të buxhetit të konsoliduar për vitin 2023”, si dhe Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024 - 2026 të UPT, është parashikuar zhvillimi i pronës me qëllim realizimi i projektit "Ngritja e Qendrës së Shërbimeve ndaj te Tretëve", vënë në dispozicion të grupit të auditimit relacioni teknik dhe projekt ideja e zhvillimit.

Me shkresën nr.363/1 datw 12.03.2024, protokolluar ne KLSH me nr. 1015/5, dt 13.3.2024, janë përcjellë sqarimet e subjektit nga Administratori i Universitetit Politeknik i Tiranës z.B.A. si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Së pari, lidhur me statusin aktual të regjistrimit të pasurisë në regjistrin e Bilancit Kontabël sqarohet se: Pasuria me nr. 5/561, në zonën kadastrale 8180, TR; O-16 është bërë pjesë e inventarit fizik të Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT), në kuadër të procesit të riorganizimit të Universitetit të Tiranës dhe ndarjes së aktivitetit të tij në dy universitete, në përputhje me VKM



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

nr. 215, datë 15.7.1991, “Për riorganizimin e Universitetit të Tiranës” dhe VKM nr. 359, datë 21.9.1991 “Për riorganizimin e disa fakulteteve të Univesiteteve”. Gjithashtu, po në vitin 1991, sipas legjislacionit të kohës, është regjistruar në Bilancin Kontabël të Rektoratit të UPT-së, në listën e aktiveve afatgjata me vlerë fillestare 67,055 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e pesë) lekë.

Rregullimet kontabël lidhur me pronat publike në përdorim të UPT –së kanë qenë kushtëzuar nga vonesat e institucioneve përgjegjëse për përcaktimin dhe miratimin e vendimeve të kalimit në përgjegjësi administrimi, inventarizimit dhe regjistrimit të pasurive të paluajtshme shtetërore, duke qenë të procedura të ndërvarura. Vlen të theksohet se që prej vitit 2014, Universiteti Politeknik i Tiranës, në kuadër të një procesi më të gjerë ndërinstitucional, ka ndjekur të gjitha procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, brenda fushës së tij të kompetencës, duke iu drejtuar në mënyrë të vazhduar institucioneve kompetente.

Së dyti, lidhur me rekomandimin nr. 1 të Projekt Raportit sipas objektit të auditimit tematik, sqarojmë si më poshtë: Sikurse konstatohet edhe nga audituesit, Universiteti Politeknik i Tiranës që prej vitit 2014 e në vijim, ka përgatitur në mënyrë të vazhduar dokumentacionin teknik në kuadër të procesit të inventarizimit dhe regjistrimit të pronave publike që posedon. Në kuadër të këtij procesi, ka realizuar dhe ka përditësuar në mënyrë të vazhdueshme rilevimet topografike, planvendosjet dhe të dhënat e pasurisë sipas kërkesave tekniko–ligjore të legjislacionit në fuqi (sikurse dëshmohet nga dokumentacioni, i cili ju është vendosur në dispozicion me shkresën tonë nr. 3767/1 prot., datë 06.12.2023). Konkretisht, për këtë pronë, pas kryerjes së aplikimit elektronik për pajisjen me statusin juridik, hartë treguese dhe kartelë pasurie, nga UPT u saktësua dokumentacioni topografik sipas këtyre dokumenteve dhe me shkresën nr. 906 prot., datë 07.04.2023, është dërguar pranë ASHK-së dhe për dijeni Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, dokumentacioni i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për nxjerrjen e VKM-së së posaçme për përgjegjësinë e administrimit të pasurisë me nr. 5/561, në zonën kadastrale 8180, TR; O-16. Në vijim të kësaj shkrese, me shkresën nr. 906/1 prot., datë 20.04.2023, UPT i ka kërkuar MAS vijimin e procedurave të kalimit në përgjegjësi administrimi të UPT të pasurisë me nr. 5/561, më sipër cituar dhe jemi në pritje të miratimit nga Këshilli i Ministrave. Në kuadër të procesit të inventarizimit dhe regjistrimit të pronave publike të UPT, si institucion i arsimit të lartë, me shkresën nr. 7983/1 prot., datë 29.12.2023, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), na është përcjellë për njohje dhe zbatim Urdhëri i Ministrisë të Arsimit nr.701, datë 26.12.2023, ku kërkohet dokumentacioni i plotë për regjistrimin e pronave të paluajtshme shtetërore që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT). Ky dokumentacion (që përfshin edhe pasurinë në fjalë) është përcjellë pranë MAS me shkresën nr. 01/1 prot., datë 05.01.2024. Me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave të listës së pronave që i kalojnë në përgjegjësi administrimi UPT - së, institucioni ynë do të ndjekë të gjitha procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për regjistrimin e pronave pranë ZRPP dhe pajisjen me certifikata pronësie. Në vijim të këtij procesi, do të kryhet vlerësimi/rivlerësimi sipas rastit i pasurive dhe regjistrimi i tyre pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), sipas legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të pajisemi me dokumentin zyrtar që pasqyron regjistrimin e rivlerësimit me vlerën e tregut, mbështetur në ekspertizën e vlerësuesit të pasurive të paluajtshme. Vlera kontabël e pasurive, qofshin këto ndërtesa, apo troje do të pasqyrohet në Bilancin Kontabël të institucionit, në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit dhe legjislacionin në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Së treti, lidhur me rekomandimin nr. 2 të Projekt Raportit sipas objektit të auditimit tematik, sqarojmë se: Në dokumentacionin e siguruar nga ASHK deri në vitin 2023 dhe të administruar nga institucioni ynë ndër vite (i cili ju është vendosur në dispozicion me shkresën tonë nr. 3767/1 prot., datë 06.12.2023) nuk ka patur informacion për kufizime të mundshme në pasurinë me nr. 5/561, në zonën kadastrale 8180, TR; O-16. Me shkresën tuaj nr. 1015/4 prot., datë 12.02.2024, protokolluar pranë UPT –së me nr. 363 prot., datë 14.02.2023, nëpërmjet së cilës dërgohet Projekt Raporti i Auditimit lidhur me pasurinë në fjalë, jemi informuar për herë të parë se në Seksionin D të kartelës së pasurisë në fjalë me reference 0008261 datë 23.03.2013, është vendosur kufizimi me shënimin “Kjo pasuri është e okupuar nga Z. V. K. B., si dhe ka tre ndërtime të paligjshme”.

Ky fakt është konfirmuar në vijim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në përgjigje të aplikimit të kryer nga Universiteti Politeknik i Tiranës për pajisjen me informacion për gjendjen juridike, kartelën e pasurisë dhe hartë treguese të kryer, me nr. 1663, datë 16.01.2024.

Sikurse konstatohet edhe në projekt raportin e auditimit tematik të hartuar nga institucioni juaj, kufizimi me shënimin “Kjo pasuri është e okupuar nga Z. Z. V. K. B., si dhe ka tre ndërtime të paligjshme”, në kartelën e pasurisë nr.1015/4 prot., datë 12.02.2024 është vendosur pa mbështetje ligjore. Pas konstatimit të këtij gabimi, UPT ka marrë masat për korrigjimin e tij, duke kryer në sistemin e-albania aplikimin elektronik me nr. 8583, datë 08.03.2024 drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me kërkesën për shërbimin korrigjim gabimesh në kartelën e pasurisë, i shoqëruar me dokumentacionin faktues. Për sa më sipër, në respektim të legjislacionit në fuqi dhe rekomandimit tuaj, nga institucioni ynë janë marrë masat për korrigjimin e gabimit në kartelën e pasurisë së paluajtshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit të KLSH, konstaton se shpjegimet e subjektit me shkresën nr.363/1 prot., datë 12.03.2024 pohojnë gjetjet e konstatuara. Gjithashtu sqarojmë se nuk ka evidencë shtesw dhe as bazë ligjore të re nga ato të trajtuara në akt-konstatim dhe projektraportin e auditimit. Sa më sipër nga ana e grupit të auditimit mbahet i njëjti qëndrim.

Për shqyrtimin e plotë të ankesës, me shkresën nr.1015/2 prot., datë 10.01.2024 nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit ***iu kërkua Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë Vendore Tirana Jug, informacion i plotë lidhur me statusin juridik të pasurisë objekt ankese.***

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug, me shkresën “Kthim përgjigje” nr. 79/1 prot., datë 12.01.2024 protokolluar në KLSH me nr. 1015/3 prot., datë 17.01.2024 konfirmoi se:

- Pasuria me emërtimin “Parku i Akademisë së Shkencave”, regjistruar në kartelat e pasurisë me nr.5/167,vol.17, fq.163 rezulton në pronësi Republika e Shqipërisë me datë lëshimi certifikate 15.12.2017 në bazë të VKM-së nr.1320 datë 24.09.2008 “Për një ndryshim në VKM nr.250 datë 24.04.2003 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore” që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”.

Lidhur me pasurinë “Parku i Universitetit të Tiranës” nr. 5/561, volumni 22 fq.87, zk 8180,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

rezulton

e afishuar në emër *Shtet*, e cila:

- në seksionin “C” të kartelës së pasurisë lëshuar elektronikisht, me datë 05.12.2023 ka të vendosur shënimin me referencë 00013917, datë 04.01.2019, “*Sipas Vendimit të Kthimit e Kompensimit të Pronave, Kryegjyshata Botërore ka të drejtën e parablerjes*”
- në seksion D të kësaj karteje me reference 0008261 datë 23.03.2013 është vendosur kufizimi me shënimin “*Kjo pasuri është okupuar nga z.V.K.B., si dhe ka tre ndërtime të paligjshme*”.

Në shkresën me lëndë “Kthim përgjigje” nr. 79/1 prot., datë 12.01.2024 të dërguar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug dhe e protokolluar në KLSH me nr. 1015/3 prot., datë 17.01.2024, citohet se:

- Vendimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nr. 948 datë 12.12.1994 është i shoqëruar edhe me planvendosjen e objekteve, ***por gjatë procesit të regjistrimit fillestar për shkak të gabimi material nuk është pasqyruar objekti në kartelën e pasurisë për të cilën gëzon të drejtën e parablerjes Kryegjyshata, por është krijuar kartela e pasurisë vetëm si truall me sipërfaqe 1338 m².***

Gjithashtu në shkresën “Kthim përgjigje” nr. 79/1 prot., datë 12.01.2024 protokolluar në KLSH me nr. 1015/3 prot., datë 17.01.2024 informohet se:

- ***nga verifikimet e kryera nga punonjësit e ASHK-së nuk rezulton të ketë vetdeklarim për përfshirjen në proces legalizimi nga persona okupues apo të tjerë për objekte të paligjshme të ndodhura në këtë pasuri.***

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua që:

Titulli i gjetjes nr. 1	Mos regjistrimi pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës si pasuri në përgjegjësi administrimi i Universiteti Politeknik i Tiranës
Situata:	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës u konstatua se pasuria nr. 5/561, objekt i ankesës, nuk është regjistruar në kartelat e pasurive pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si pronë në përgjegjësi administrimi të Universitetit Politeknik të Tiranës, por ky i fundit ka të regjistruara në kontabilitet në zërin e aktiveve afatgjata materiale godinat –pjesë e kësaj pasurie, <i>(në inventarin kontabël të llogarisë 212, “Ndërtesa dhe konstruksione”, regjistruar kjo godinë që nga viti 1991 me emërtimin “Oficina e Transportit”), bazuar në VKM-në nr. 215, datë 15.7.1991, “Për riorganizimin e Universitetit të Tiranës” dhe VKM-në nr. 359, datë 21.9.1991 “Për riorganizimin e disa fakulteteve të Universiteteve”.</i></p> <p>Në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” nuk kanë të regjistruar asnjë pronë/truall si aktive afatgjata materiale dhe rezulton me vlerën zero. Sa më sipër, vepruar në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet afatgjata materiale</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

	dhe aktivet afatgjata jomateriale”, paragrafi 20 dhe 21, dhe paragrafit nr.21, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit SKK 1 “Kuari i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”, si dhe VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, etj.
Kriteri:	-Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; -Ligji nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, Ligji nr. 111/2018, “Për kadastrën”, VKM-në nr. 782, datë 07.10.2020, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.
Ndikimi/Efekti:	Risku i krijimit të problematikës mbi administrimin e pronës
Shkaku:	Nga aktet shkresore të administruara, konkretisht rezultojnë se nga viti 2014 deri 2023 UPT ka kryer aplikime/korrespondenca të nevojshme me institucionet kompetente për kalimin në përgjegjësi administrimi të pronave të paluajtshme në posedim prej tij, përfshirë edhe pronën e paluajtshme shtetërore me nr. pasurie 5/561, në zonën kadastrale 8180, indeksi i hartës TR-O-16, por nuk është finalizuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	UPT të ngrejë një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokave, trojeve dhe terreneve që i përkasin institucionit dhe pas përlogaritjes së vlerave nga ekspertët e fushës, të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit të saj në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
Titulli i gjetjes nr. 2	Verifikim i dokumentacionit të ASHK-së lidhur me statusin juridik të pasurisë nr. 5/561, objekt i ankesës
Situata:	Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, lidhur me referencën 00013917 dhe referencën 0008261 si dhe shkresën me objekt “Kthim përgjigje” të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug me nr. 79/1 prot., datë 12.01.2024, (protokolluar në KLSH me nr. 1015/3 prot., datë 17.01.2024) rezultojnë se, pasuria 5/561, objekt i ankesës, në Kadastër është regjistruar vetëm si truall, në emërtesën “Shtet”, duke mos pasqyruar në kartelën e pasurisë objektin me sipërfaqen përkatëse për të cilin ka të drejtën e parablerjes Kryegjiyshata Botërore e Bektashinjve, bazuar në Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave me nr. 948, datë 12.12.1994, (regjistruar në Seksionin C të Kartelës). Gjithashtu referuar dokumentacionit të sipërcituar rezultojnë se në seksionin përkatës të kartelës për kufizimet mbi pasurinë nuk vërtetohet me dokumentacion ekzistenca e ndërtimeve të paligjshme (të regjistruara në kartelë), fakt ky i konfirmuar nga verifikimet e grupit të auditimit dhe nga informacioni i dërguar nga ASHK, Drejtoria Vendore Tirana



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

	<p>Jug.</p> <p>Me shkresën nr.2767/1 prot., datë 06.12.2023 të Universitetit Politeknik të Tiranës me lëndë “Informacion në kuadër të verifikimit”, theksohet se objektet në këtë pronë kanë shërbyer për riparimin dhe qëndrimin e automjeteve të institucionit, etj., ndërsa aktualisht përdoren për administrimin e automjeteve, magazinimin e bazës materiale, të fakulteteve të UPT.</p>
Kriteri:	Shkresa nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug nr. 97/1 prot., datë 12.01.2024
Ndikimi/Efekti:	Risku i mosevidentimit të saktë të së drejtës së parablerjes të pasurisë sipas vendimit të kthimit dhe kompensimit të pronave nr.948 datë 12.12.1994.
Shkaku:	Gabimet materiale gjatë procesit të regjistrimit fillestar, duke mospasqyruar objektin real, për pasurinë që gëzon të drejtën e parablerjes nr. 5/561,volumi 22 fq.87, zk 8180 si dhe kufizimet e pasurisë pa mbështetje ligjore.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	<p>2.1 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, si autoritet përgjegjës, Universiteti Politeknik i Tiranës si dhe Kryegjyshata Botërore e Bektashinjve, si subjekte/ persona me interes të ligjshëm², sipas nenit 4 pika 2 dhe bazuar në nenin 16 e 37, të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, të ndërmarrin veprimet e nevojshme me qëllim korrigjimin e gabimeve materiale të krijuara gjatë procesit të regjistrimit fillestar, për të bërë të mundur pasqyrimin në seksionin përkatës të Kartelës së Pasurisë nr. 5/561, volumi 22, fq.87, ZK 8180, objektin real si dhe fshirjen e kufizimit të vendosur pa mbështetje ligjore.</p> <p>2.2. Strukturat përkatëse pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në ushtrim të të drejtës së përfaqësuesit të pronës shtetërore, referuar nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.04.1995 i ndryshuar, si dhe në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” me ndryshimet dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, të marrin masat për shqyrtimin dhe analizimin e statusit aktual të pronës në lidhje me zhvillimin e saj, duke koordinuar veprimet me Universitetin Politeknik të Tiranës për sa më sipër.</p> <p>2.3. Institucionet shtetërore përgjegjëse të ndërmarrin procedurat për zhvillimin e pronës, bazuar në Nenin 22, pika 2, të Ligjit Nr.10058, datë 22.1.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshit Botërore Bektashiane për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, ku përcaktohet se “Shteti do t’i kthejë dhe kompensojë Kryegjyshitës</p>

² - Neni 4 pika 2: Persona me interes të ligjshëm janë personat e tretë, të drejtat e të cilëve kanë të bëjnë me pasurinë për të cilën kërkohen të dhëna (sipas dokumentacionit provues) apo që ushtrjnë funksione publike, për realizimin e të cilave janë të nevojshme këto të dhëna.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Botërore Bektashiane të gjitha pronat, me përparësi objektet e kultit tashmë të njohura nga të gjithë, të cilat kanë qenë për shekuj qendra shpirtërore dhe kulturore të komunitetit bektashian dhe përbëjnë historinë e këtij komuniteti, si objektet e kultit, vendet e shenjta, sendet e kultit dhe arkivat e saj të konfiskuara nga regjimi komunist” dhe Nenin 14, “E drejta e parablerjes”, pika 1, e Ligjit Nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, që shpreh se “Për pronat e paluajtshme të zëna me objekte shtetërore, subjektet e shpronësuara kanë të drejtën e parablerjes mbi këto objekte kur ato të privatizohen. E drejta e parablerjes regjistrohet në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. Në kushtet që Universiteti Politeknik i Tiranës nuk zotëron asnjë titull pronësie për pasurinë nr. 5/561, si dhe vlera e truallit nuk është regjistruar në kontabilitetin e tij, për të cilën Kryegjyshata Botërore Bektashiane edhe sipas regjistrave të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ka të drejta reale pronësore, referuar Vendimit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nr. 948, datë 12.12.1994, pika 2/b, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të vlerësojë iniciimin e procedurave të nevojshme ligjore me qëllim vënien në dobi të komunitetit bektashian të kësaj prone dhe, aty ku sipas ligjit kjo është e pamundur, kompensimin e saj.



IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës u konstatua se pasuria nr. 5/561, objekt i ankesës, nuk është regjistruar në kartelat e pasurive pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si pronë në përgjegjësi administrimi të Universitetit Politeknik të Tiranës, ndonëse Universiteti ka të regjistruar në kontabilitet në zërin e aktiveve afatgjata materiale, godinat –pjesë e kësaj pasurie, (në inventarin kontabël të llogarisë 212, “Ndërtesa dhe konstruksione”, *evidentohet e* regjistruar që nga viti 1991 godina me emërtimin “Ofiçina e Transportit”), bazuar në VKM-në nr. 215, datë 15.7.1991, “Për riorganizimin e Universitetit të Tiranës” dhe VKM-në nr. 359, datë 21.9.1991 “Për riorganizimin e disa fakulteteve të Universiteteve”.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. II, faqe 11-20 të Raportit të Auditimit)

1.2. Gjetje nga auditimi: Universiteti Politeknik i Tiranës, në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” nuk ka të regjistruar asnjë pronë/truall si aktiv afatgjatë material dhe si rrjedhojë në pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore, vlera e tyre rezulton të jetë zero. Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, paragrafi 20 dhe 21, dhe paragrafin nr.21, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit SKK 1 “Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”, VKM nr. 89, datë 3.2.2016 ”Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, etj.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. II, faqe 11-20 të Raportit të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Universiteti Politeknik i Tiranës të ngrëjë një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqeve të tokave, trojeve dhe terreneve që i përkasin institucionit dhe pas përllogaritjes së vlerave nga ekspertët e fushës, të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit të saj në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Menjëherë e në vijimësi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

2. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, lidhur me referencën 00013917 dhe referencën 0008261 si dhe shkresën me objekt “Kthim përgjigje” të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug me nr. 79/1 prot., datë 12.01.2024, (protokolluar në KLSH me nr. 1015/3 prot., datë 17.01.2024) rezulton se, pasuria 5/561, objekt i ankesës, në Kadastër është regjistruar vetëm si truall, në emërtesën “Shtet”, duke mos pasqyruar në kartelën e pasurisë objektin me sipërfaqen përkatëse për të cilin ka të drejtën e parablerjes Kryegjyshata Botërore e Bektashinjve, bazuar në Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave me nr. 948, datë 12.12.1994, (regjistruar në Seksionin C të Kartelës). Gjithashtu referuar dokumentacionit të sipërcituar rezulton se në seksionin përkatës të kartelës për kufizimet mbi pasurinë nuk vërtetohet me dokumentacion ekzistenca e ndërtimeve të paligjshme (të regjistruara në kartelë), fakt ky i konfirmuar nga verifikimet e grupit të auditimit dhe nga informacioni i dërguar nga ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Jug.

Me shkresën nr.2767/1 prot., datë 06.12.2023 të Universitetit Politeknik të Tiranës me lëndë “Informacion në kuadër të verifikimit”, theksohet se objektet në këtë pronë kanë shërbyer për riparimin dhe qëndrimin e automjeteve të institucionit, etj., ndërsa aktualisht përdoren për administrimin e automjeteve, magazinimin e bazës materiale, të fakulteteve të UPT.
(Hollësisht trajtuar në pikën nr. II, faqe 11-20 të Raportit të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, si autoritet përgjegjës, Universiteti Politeknik i Tiranës si dhe Kryegjyshata Botërore e Bektashinjve, si subjekte/ persona me interes të ligjshëm³, sipas nenit 4 pika 2 dhe bazuar në nenin 16 e 37, të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, të ndërmarrin veprimet e nevojshme me qëllim korrigjimin e gabimeve materiale të krijuara gjatë procesit të regjistrimit fillestar, për të bërë të mundur pasqyrimin në seksionin përkatës të Kartelës së Pasurisë nr. 5/561, volumni 22, fq.87, ZK 8180, objektin real si dhe fshirjen e kufizimit të vendosur pa mbështetje ligjore.

Menjëherë e në vijimësi

2.2. Rekomandimi: Strukturat përkatëse pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në ushtrim të të drejtës së përfaqësuesit të pronës shtetërore, referuar nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.04.1995 i ndryshuar, si dhe në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” me ndryshimet dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, të marrin masat për shqyrtimin dhe analizimin e statusit aktual të pronës në lidhje me zhvillimin e saj, duke koordinuar veprimet me Universitetin Politeknik të Tiranës për sa më sipër.

Brenda 4 muajsh

2.3. Rekomandimi: Institucionet shtetërore përgjegjëse të ndërmarrin procedurat për zhvillimin e pronës, bazuar në Nenin 22, pika 2, të Ligjit Nr.10058, datë 22.1.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshatës

³ - Neni 4 pika 2: *Persona me interes të ligjshëm janë personat e tretë, të drejtat e të cilëve kanë të bëjnë me pasurinë për të cilën kërkohen të dhëna (sipas dokumentacionit provues) apo që ushtrojnë funksione publike, për realizimin e të cilave janë të nevojshme këto të dhëna.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Botërore Bektashiane për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, ku përcaktohet se “*Shteti do t’i kthejë dhe kompensojë Kryegjyshatës Botërore Bektashiane të gjitha pronat, me përparësi objektet e kultit tashmë të njohura nga të gjithë, të cilat kanë qenë për shekuj qendra shpirtërore dhe kulturore të komunitetit bektashian dhe përbëjnë historinë e këtij komuniteti, si objektet e kultit, vendet e shenjta, sendet e kultit dhe arkivat e saj të konfiskuara nga regjimi komunist*” dhe nenin 14, “E drejta e parablerjes”, pika 1, e Ligjit Nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, që shpreh se “*Për pronat e paluajtshme të zëna me objekte shtetërore, subjektet e shpronësuar kanë të drejtën e parablerjes mbi këto objekte kur ato të privatizohen. E drejta e parablerjes regjistrohet në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme*”. Në kushtet që Universiteti Politeknik i Tiranës nuk zotëron asnjë titull pronësie për pasurinë nr. 5/561, si dhe vlera e truallit nuk është regjistruar në kontabilitetin e tij, për të cilën Kryegjyshata Botërore Bektashiane edhe sipas regjistrave të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ka të drejta reale pronësore, referuar Vendimit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nr. 948, datë 12.12.1994, pika 2/b, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të vlerësojë iniciimin e procedurave të nevojshme ligjore me qëllim vënien në dobi të komunitetit bektashian të kësaj prone dhe, aty ku sipas ligjit kjo është e pamundur, kompensimin e saj.

Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.